



## Rrjeti i shërbimeve për biodiversitetin dhe ekosistemin

Rrjeti i shërbimeve për biodiversitetin dhe ekosistemin (BES-Net) është “rrjeti i rrjeteve” për shkëmbimin e kapaciteteve, i cili nxit dialogun ndërmjet përfaqësuesve të shkencës, politikave dhe praktikave për një menaxhim më efikas të biodiversitetit dhe ekosistemeve, duke kontribuar në një mirëqenie afatgjatë dhe zhvillim të qëndrueshëm të njerëzimit. Rrjeti mbështetet nëpërmjet veprimtarive të drejtpërdrejta për ngritjen e kapaciteteve (Trialogjet e BES-Net), veprimtarive koordinuese dhe një portal interneti i teknologjisë së fundit, ku të gjithë komponentët përforcojnë njëri tjetrin.

BES-Net drejtohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe zbatohet nëpërmjet partneriteteve me Ministrinë Gjermane për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës, Ndërtimin dhe Sigurinë Bërthamore (BMUB), Agjencinë Norvegjeze të Mjedisit dhe SwedBio në Qendrën për Ripërtëritje në Stokholm. Nëpërmjet BES-Net, PNUD kontribuon në punën e Platformës Ndërqeveritare të Shërbimeve të Biodiversitetit dhe Ekosistemit (IPBES) për ngritjen e kapaciteteve. BES-Net lehtëson dhe nxit dialogun për temat që janë kryefjalë e vlerësimeve globale të IPBES dhe në fusha kyçe të punës së PNUD-it për menaxhimin e biodiversitetit dhe ekosistemeve. BES-Net shfrytëzon ekspertizën e PNUD-it në ngritjen e kapaciteteve në nivel kombëtar, mbështetet në njohuritë e grumbulluara për praktikën më të mira dhe sfidat në këtë fushë, dhe sjell profesionistët në arenën e shkencës dhe të politikave.

Në zbatimin e mandatit të tij, BES-Net ndjek një qasje përfshirëse, duke bashkëpunuar me Marrëveshjet Mjedisore Shumëpalëshe përkatëse dhe duke marrë mbështetjen e shumë organizatave të tjera partnere.

### Veprimtaritë e BES-Net

#### Portali elektronik i BES-Net

Portali elektronik i BES-Net shërben si sportel me një ndalesë për shpërndarjen e informacioneve dhe materialeve të mësimin në lidhje me politikën, duke i udhëzuar përdoruesit nëpërmjet burimeve ekzistuese të informacioneve tematike dhe instrumenteve metodologjike dhe duke ofruar qasje në materiale mësimi dhe informuese për politikën. Ai nxit dialogun për fusha tematike të njëjta me ato ku po kryhen vlerësimet e IPBES, si edhe në fusha kyçe të punës së PNUD-it për menaxhimin e biodiversitetit dhe ekosistemeve për zhvillim. Ai gjithashtu ofron disa tipare ndërvepruese ku anëtarët e rrjetit mund të ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë për pyetje specifike për politikën.

Aty mund të gjenden module të plota për *degradimin dhe rikuperimin e tokës, polenizuesit, polenizimin dhe prodhimin ushqimor, përshtatjen e bazuar në ekosistem, si edhe për dimensionin financiar të biodiversitetit.*

Tiparet ndërvepruese të faqes së internetit u lejojnë përdoruesve:

- Të sugjerojnë materiale të reja (për organizimin, hyrje të reja në bibliotekë, në nivel ekspert);
- Të kërkojnë zhvillimin e një materiali informues për politikën;
- Të identifikojnë mangësi në njohuri;
- Të pyesin/të intervistojnë ekspertët ndërkombëtarë; dhe
- Të shkëmbejnë përvojën dhe kontributet nëpërmjet forumeve në internet.

Vini re se elementet aktuale IPBES të faqes së internetit po finalizohen në bashkëpunim me IPBES.

#### Instrumenti koordinues

Instrumenti koordinues i BES-Net aktualisht përmban një seksion për vendet e lira të punës të menaxhuar nga BES-Net ku ofrohen informacione për vendet e punës dhe praktikën profesionale të disponueshme në fushën e shërbimeve për biodiversitetin dhe ekosistemin. Shumë shpejt ai do të përmbajë edhe elemente të tjera koordinuese, bazuar në nevojat e rrjetit të BES-Net.

#### Trialogjet e BES-Net

Veprimtaritë e drejtpërdrejta për ngritjen e kapaciteteve - “Trialogjet” e BES-Net - janë dialogë shumëpalësh që përqendrohen në pyetjet specifike për politikën në nivel kombëtar dhe rajonal. Duke mundësuar diskutime të frytshme ndërmjet tre komuniteteve të BES-Net, atij të politikave, shkencës dhe praktikës, trialogjet synojnë të kontribuojnë në trajtimin e çështjeve specifike në lidhje me politikën për të ndihmuar në zgjidhjen e problematikave në trajektoren e zhvillimit të shoqërive drejt qëndrueshmërisë. Trialogjet në veçanti:

1. Do të shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet komuniteteve të shkencës, politikave dhe praktikës nëpërmjet dialogut ndërkulturor;
2. Do të krijojnë një hapësirë të përbashkët për vlerësimin e përbashkët të njohurive me rëndësi për rajonin dhe për identifikimin e përbashkët të politikave që ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për rajonin; dhe
3. Do të përgatisin një axhendë të përbashkët për veprim.



Gjatë raundit të parë, dialogjet e BES-Net synojnë të mbështesin përthithjen e vlerësimeve tematike të përfunduara të IPBES. Aktualisht, dialogjet financohen nga BMUB me fonde plotësuese nga SwedBio. Dialogjet ofrojnë:

- Përgatitje të përshtatur, duke përfshirë përzgjedhjen e synuar të pjesëmarrësve nga tre komunitetet e shkencës/zotëruesit e njohurive, politikave, praktikës për të garantuar që njerëzit të mund të japin një kontribut efikas në diskutime dhe të kenë kompetencat për të ndërmarrë veprime pas diskutimeve. Procesi që paraprin dialogun do të përfshijë zhvillimin me pjesëmarrje të një dokumenti informues, trajnimin e një bashkë-moderatori lokal dhe përzgjedhjen dhe trajnimin e folësve;
- Metodologjia e teknologjisë së fundit e dialogut, që synon të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet kulturave dhe komuniteteve të shkencës, politikave dhe praktikës, ofron një shpjegim më të thellë të perspektivave dhe praktikave të ndryshme, krijon një hapësirë të përbashkët për vlerësimin e përbashkët të njohurive me rëndësi për rajonin dhe krijon një axhendë të përbashkët për veprim. Çdo aktivitet do të bashkëmoderohet nga një ekip i përbërë nga moderatorë globalë dhe lokalë.
- Do të prodhohet një dokument i orientuar drejt veprimit, i cili përfshin një grup veprimesh konkrete që përfshihen në mandatin/kapacitetin e komunitetit të dialogut, ku identifikohen hapësira për zhvillimin e politikave dhe mundësitë për ta integruar menaxhimin e biodiversitetit në programet për zhvillim. Gjithë kjo veprimtari mbështetet në partneritetet rajonale dhe kombëtare, të cilat ofrojnë mbështetje dhe vazhdimësi për axhendën e përbashkët për veprim dhe për rrjetëzimin rajonal. Ndjekje sistematike që mundëson shpërndarjen e gjerë të rezultateve të aktivitetit dhe që u lejon pjesëmarrësve që të vazhdojnë të diskutojnë çështjet e trajtuara nga dialogjet edhe në internet, me një komunitet më të gjerë ekspertësh të organizuar në portalin elektronik të BES-Net; dhe
- Një metodologji e teknologjisë së fundit për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimin që kanë dialogjet në ngritjen e kapaciteteve, e cila do të japë informacione për përmirësimin e tyre të vazhdueshëm.

Dialogjet rajonale do të jenë aktivitete tre ditore ku përfshihen segmente të nivelit të lartë me përfaqësues të shtypit dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga qeveritë përkatëse dhe aktorë të tjerë kyçë në këtë fushë. Aktiviteti do të mbledhë afërsisht 50 pjesëmarrës nga 5 vende të ndryshme në rajon dhe do të organizohet me mbështetjen nga vendi pritës, Qendra Rajonale e PNUD-it dhe drejtuesit vendas të PNUD-it, si edhe nga partnerët lokalë.

### **Dialogu i parë i BES-Net në Evropën Lindore**

Evropa Lindore është zgjedhur si rajoni për të mbajtur dialogun e parë për polenizuesit, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural duke përdorur gjetjet përkatëse të **vlerësimit të IPBES**. Ai do të organizohet në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, më 18-20 tetor 2017, do të drejtohet nga Ministria Federale e Mjedisit dhe Turizmit në Bosnjë-Hercegovinë si pika e kontaktit e IPBES, me mbështetjen e Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Biodiversiteti (ORF-BD), i cili financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Ky aktivitet do të mbledhë së bashku 50 grupe interesi nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Gjeorgjia, Moldavia dhe Mali i Zi, si përfaqësues të tre komuniteteve të BES-Net të fermerëve dhe bletarëve vendas, shkencëtarëve dhe politikëbërësve. Në këtë aktivitet do të përfshihen edhe segmente të nivelit të lartë si edhe shtypi.

Gjatë Dialogut, pjesëmarrësit do të vlerësojnë së bashku situatën aktuale, duke përfshirë ndikimin ekonomik dhe faktorët nxitës të rënies së numrit të polenizuesve në rajon, mënyrën se si ndikon kjo në biodiversitet si edhe shërbimet që polenizuesit ofrojnë për bujqësinë, agro-biznesin dhe sigurinë ushqimore, si edhe përfitimet e përbashkëta të rëndësishme nga menaxhimi i qëndrueshëm i polenizuesve dhe habitatit të tyre, me qëllim që të arrihet një përshtatje e bazuar në ekosistem. Për më shumë informacione, klikoni në <http://www.besnet.world/node/1936>.

**UNDP Global Policy Centre on Resilient Ecosystems and Desertification (GC-RED)**

P.O. Box 30218-00100, Nairobi, Kenya

Tel: (254-20) 7624640/42 | Email: [info@besnet.world](mailto:info@besnet.world) | Web: <http://www.besnet.world>



Implemented by  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Federal Ministry for the  
Environment, Nature Conservation,  
Building and Nuclear Safety

**SwedBio**  
A programme at Stockholm Resilience Centre



Empowered lives  
Resilient nations